



Nr. 3003 Rep.

Nr. 232 Kol.

**KONTRATË SHITBLERJE**  
Kuotave të shoqërisë "MALIDO" Sh.p.k  
BAZA LIGJORE  
Nenet 6, 705 – 750 të Kodit Civil

Në Lezhë, sot më 20.10.2018 (dymijë tetëmbëdhjetë), para meje noterit publik Emanuel N. Gjura, anëtar i Dhomës së Noterisë Shkodër, me seli në Lezhë, në rrugën "Frang Bardhi", u paraqitën personalisht:

**SHITËSI:**

1. **Ardian Tushaj**, i datëlindjes 04.11.1968, lindur ne Rreshen Mirdite dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor me zotësi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. personal G81104045P, si pjese e regjimit martesor jep pelqimin bashkeshortja zj. Luiza Tushaj e datelindjes 04.07.1975, lindur ne Mat dhe banuese ne Tirane, shtetase shqiptare, madhore me zotësi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. Personal H55704041H.

2. **Petrit Preçi** i datëlindjes 01.01.1975, lindur ne Fregen Lezhe dhe banues ne Lezhe, shtetas shqiptar, madhor me zotësi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. Personal H50101063R, si pjese e regjimit martesor jep pelqimin bashkeshortja zj. Shqiponja Preçi e datelindjes 19.05.1983, lindur ne Rubik Mirdite dhe banuese ne Lezhe, shtetase shqiptare, madhore me zotësi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. Personal I355190300.

3. **Rudin Deda** i datëlindjes 05.04.1971, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor me zotësi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. Personal H10405184B, si pjese e regjimit martesor jep pelqimin bashkeshortja zj. Albana Deda e datelindjes 18.02.1976, lindur ne Kruje dhe banuese ne Tirane, shtetase shqiptare, madhore me zotësi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. Personal H65218125C.

Ne cilesine e ortakëve dhe pronarëve te 100 % te kuotave te kapitalit te shoqërisë MALIDO sh.p.k., regjistruar ne QKB (Qendren Kombetare te Biznesit) me date 01.01.2003 dhe themeluar me date 12.02.1995, me Numer Unik Identifikimi Subjekti NUIS K38707048Q, me seli ne Zejmen Lezhe,  
(i quajtur me poshte **SHITËSI**)

Shitesit pas mbledhjes se Asamblese se Ortakëve te shoqërisë "MALIDO - ENERGJI" Shpk nr. 21 date 01.10.2018, per dhenien e pelqimit te shitjes se kuotave te shoqërisë "MALIDO", Shoqëria "MALIDO" sh.p.k vendosi me vendim Asambleje nr. 17 date 08.10.2018, shitjen e 100 % te kuotave.

**DHE**

**BLERËSI:**

**SHOQËRIA "NEW TECHNOLOGY HYDROPOWER" Shpk**, me seli ne Durres, Lgj. nr.13 Rr. " Dhimiter Kaja ", regjistruar ne QKR (Qendren Kombetare te Regjistrimit) me date 21.05.2018 dhe themeluar me date 15.05.2018, me Numer Unik Identifikimi Subjekti NUIS L81721501B, perfaqesuar nga administratori Z. **Besnik Leka** i datëlindjes 15.10.1977, lindur ne Gose Kavaje dhe banues ne Durres, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi te plotë juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet pasaportes me nr. Personal H71015159U.  
(i quajtur me poshte **BLERËSI**).

Duke marre parasysh se:



A ) SHITESI është ortak dhe pronar i 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë MALIDO sh.p.k., e quajtur me poshtë SHOQERIA, regjistruar në QKB (Qendren Kombëtare të Biznesit) me datë 01.01.2003 dhe themeluar me datë 12.02.1995, me Numer Unik Identifikimi Subjekti NUIS K38707048Q, me seli në Zëjmen Dëshë dhe ka shprehur vullnetin për të shitur të gjitha kuotat e shoqërisë që përbejnë 100 % të kuotave të kapitalit të saj e ndare midis ortakëve si më poshtë :

- **Ardian Tushaj** shet 46 % të Kuotave
- **Petrit Preçi** shet 46% të Kuotave
- **Rudin Deda** shet 8 % të kutave

B ) BLERESI nepermjet vendimit të Asamblese të ortakëve të shoqërisë të datës 19.10.2018 ka shprehur vullnetin për të blere të gjitha kuotat e shoqërisë "MALIDO" shpk që përbejnë 100 % të kuotave të kapitalit të saj.

Palet bien dakort të hartojnë dhe të firmosin këto kontrate:

1. Shitesi shet dhe bleresi blen 100 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë në pronësi të shitesit sic janë identifikuar në paragrafin A.
2. Palet kanë rënë dakort që çmimi i përgjithshëm që bleresi do të pagojë shitesit për transferimin e pronësive të të gjithë kapitalit të shoqërisë është NE TOTAL 160.000 EURO dhe përkatësisht sipas ndarjes:
  - **Ardian Tushaj** shet 46 % të Kuotave me vlerën 73.600 EURO
  - **Petrit Preçi** shet 46% të Kuotave me vlerën 73.600 EURO
  - **Rudin Deda** shet 8 % të kutave me vlerën 12.800 EURO

Palet deklarojnë se çmimi do të likujdohet në llogarinë bankare të noterit, nga bleresi në favor të shitesit, brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditor nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, me pas noterit do të bëjë kalimin e shumës sipas vlerave të sipërcituara në llogaritë përkatëse të ortakëve (shitesi).

3. Bleresi pranon dhe blen kuotat e përmendura në paragrafin 1, pa asnjë pretendim apo kundërshtim të çdo natyre të tashme/të ardhme ose të lidhur me to.
4. **Shitesi deklaron dhe garanton bleresin për sa më poshtë:**
  - a) Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe funksionon në bazë të lejeve dhe autorizimeve të kërkuara nga ligji për ushtrimin e aktivitetit të saj.
  - b) Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga 100.000 Lek i ndare në 100 kuota. Kuotat përfaqësojnë 100% të kapitalit aktual. I gjithë kapitali është nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ortakët dhe nuk ekziston asnjë detyrim i metejshëm për nënshkrimin ose shlyerjen e kapitalit themeltar. Shitesi gëzon të drejtë të plotë pronësie mbi kuotat e shoqërisë dhe gjithashtu posedon dhe merr çdo lloj tjetër frytësh ose interesash që lindin nga pronësia e kuotave.
  - c) Të gjitha lejet dhe autorizimet janë leshuar në emër të shoqërisë dhe e lejojnë atë të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar në Shqipëri në përputhje me normatën e fuqi. Shoqëria ka shlyer gjithashtu të gjitha detyrimet që janë të nevojshme për përshtatshmerinë, vlerën dhe kohezgjatjen e lejeve dhe autorizimeve.
  - d) Asetet dhe pasuritë (të luajtshme dhe të paluajtshme) të shoqërisë janë të lira nga çfarëdo lloj pengu, hipoteke, fidejusioni, dorezanie, garancie pasurore apo garanci të tjera reale ose personale, të cilat kanë ose mund të kenë efekte materiale negative mbi aktivitetin ose situatën financiare të shoqërisë.
  - e) Shitesi deklaron që shoqëria nuk ka kryer asnjë akt ose aktivitet të kundraligjshëm duke vepruar gjithmone konform ligjit. Të gjitha deklaratimet fiskale dhe raportet e shoqërisë të kërkuara nga ligji rezultojnë të depozituara pranë autoriteteve përkatëse. Informacionet dhe vlerësimet financiare janë dorëzuar sikundër rezultojnë gjithashtu të paguara të gjitha detyrimet fiskale, tarifal, pagesat dhe kontributet që duhen shlyer për shoqërinë, asetet ose të ardhurat e saj.
  - f) Shitesi deklaron se nuk rezultojnë obligacione ose detyrime të pashlyera në kontratat ose marrëveshjet në të cilat shoqëria është pale dhe nuk ekziston asnjë arsye ose tregues për mosrespektimin e tyre. Shoqëria nuk është pale dhe nuk është në dijeni të jete pale në ndonjë çështje gjyqësore civile, penale, administrative ose arbitrazhi, zhvillimi i të cilave mund të ndikojë negativisht mbi transaksionet e shoqërisë, mbi kushtet e saj operative dhe financiare ose mbi kapacitetin e saj për përmbushjen e impenjimeve të mara.





g) Shitesi deklaron dhe garanton bleresin qe ky i fundit nuk do te ngarkohet me asnje lloj pergjegjesie per pretendimet e mundeshme qe mund te lindin ndaj shoqerise per aktivitetet e kryera ne periudhen qe kalon nga nenshkrimi i kesaj kontrate deri ne pagesen e cmimit sipas menyrove dhe koheve per te cilat eshte rene dakort.

**5. Bleresi deklaron dhe garanton shitesin sa me poshte:**

- a) Kjo kontrate krijon per bleresin nje detyrim te vlefshem dhe ligjor, shlyerja e te cilit nuk passjell asnje shkelje te normave ose rregulloreve kombetare dhe nderkombetare te aplikueshme per bleresin.
- b) Per blerjen e kuotave bleresi duhet ti paguaje shitesit shumen ne vleren ne total prej 160.000 EURO , si cmim i rene dakort per transferimin e kuotave qe perfaqesojne te gjitha kapitalin e shoqerise. Pagesa do te kryhet ne momentin e nenshkimit te kesaj kontrate ( brenda afatit 15 ditor ).
- c) *Kalimi i pronesise nga Shitesi tek bleresi do behet ne momentin e likujdimit te plote te shumes se sipershenuar ne llogarine e noterit.*
- d) Data e transferimit te pronesise do te konsiderohet data e regjistrimit te ketij transferimi prane QKB (Qendra Kombetare e Biznesit ). Ne kete date bleresi do te quhet pronar i vetem te te gjitha kuotave te shoqerise sikunder shitesi nuk do te kete me ne pronesi asnje kuote te saj.
- e) Ne perputhje me germen (b), bleresi do te kryeje pagesen e cmimit me kusht qe te mos rezultojte asnje detyrim i shoqerise, lindur perpara nenshkimit te kesaj kontrate dhe per te cilin bleresi nuk ishte vene ne dijeni paraprakisht.

Kontrata iu lexohet paleve te cilet e kuptojne, e pranojne permbajtjen e aktit dhe e nenshkruajne ate pa verejtje , duke vene emerin, e mbiemrin , forme e nenshkrimit kjo e percaktuar ne nenin 46 te ligjit nr. 7829 date 01.06.1994 " per Noterine " i ndryshuar "

Kontrata redaktohet ne kater kopje me permbajtje dhe vlere te njete juridike.

Une noterja vertetoj redaktimin korrekt te aktit dhe autenticitetin e nenskrimeve , ne baze te ligjit 7829 date 01.06.1994 " per Noterine " i ndryshuar " .

**SHITESI**  
Shoqeria MALIBO shpk  
Ortaketi

MALIBO SHPK  
387070480

Ardian Tushaj

1. Ardian Tushaj  
Bashkeshortja: Luiza Tushaj

Luiza Tushaj

Petrit Preçi

2. Petrit Preçi  
Bashkeshortja: Shqiponja Preçi

Rudin Deda

3. Rudin Deda  
Bashkeshortja: Albana Deda

Albana Deda

**BLERESI**  
Shoqeria " new Technology Hydropower " shpk  
Administrator

1. Besnik Daku  
Besnik Daku

NOTER  
EMANUEL N. GJURA

Emmanuel Gjura

# REPUBLIKA E SHQIPERISE



**DHOMA E NOTERISE SHKODER**  
**ZYRA E NOTERISE LEZHE**  
**NOTER**  
**FRAN GJONI**  
**LEZHE**

taksa pulles u pagua

NR 314 REP  
NR 117 KOL



Cel. +355 67 20 86 788, Tel. & Fax.: +355 215 23 601, E-mail: gjofra00@yahoo.com

## **ANEKS-KONTRATE** **SHITJEBLERJE - KUOTASH** **Nr.3003Rep e Nr.2232Kol date 20.10.2018**

Ne Lezhe, me date 13.01.2019 para meje Noterit **Fran Gj.Gjoni** me zyre ne Rrugen "Luigj Gurakuqi" te qytetit Lezhe u paraqiten, personat e meposhtem te cilet kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitje si me poshte:

### **PALA SHITSESE**

**1. Shoqeria Malido Shpk** me seli ne Zejmen, Lezhe rregjistruar ne QKB me NUIS K38707048Q me administrator **Petrit Preçi** i biri i Llesh i datelindjes 01.01.1975, lindur ne Fregen ,Lezhe dhe banues ne Lezhe madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numer personale H50101063R. i cili eshte ortak i shoqerise **Malido Shpk** dhe zoteron 46% te kotave te kapitalit te shoqerise .

### **Dhe ortakët.**

**2. Z. Ardian Tushaj** , i biri i Ndue, datelindjes 04.11.1968 lindur ne Rreshen , Mirdite dhe banues ne Tirane , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numer personale G81104045P. i cili eshte ortak i shoqerise **Malido Shpk** dhe zoteron 46% te kotave te kapitalit te shoqerise

**3. Z. Rudin Deda** i biri i Pal i datelindjes 05. 04.1971, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numer personale H10405184BP. i cili eshte ortak i shoqerise **Malido Shpk** dhe zoteron 8% te kotave te kapitalit te shoqerise

**Shoqeria Malido shpk eshte pjese shoqerise Malido -Energji shpk dhe zoteron 27% te kuotave te kapitali te shoqerise.**

### **PALA BLERESI:**

1. Shoqeria " **NEW TECHNOLOGY HYDROPOWER** " **Shpk**, me seli ne Durres ,Lagjia nr.13 Rr. " Dhimiter Kaja", rregjistruar ne QKB me NUIS L81721501B, perfaqesuar nga administratori **Z. Besnik Leka** i biri i Ismail i datelindjes ne 15.10.1977 lindur ne Gose, Kavaje dhe banues ne Lagjia nr.13 Durres madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i pasaportes me numer personale H71015159U.

Palet e mesiperme kane nenshkruar Kontrate Shitblerje Kuotash me Nr.3003Rep e Nr.2232Kol date 20.10.2018 ku pala shitese shoqeria Malido shpk i ka shituar shoqerise " **NEW TECHNOLOGY HYDROPOWER** " Shpk 100% te kuotave te kapitali te saje.

Shoqeri **Malido shpk** ka 27% te aksioneve te shoqerine "**Malido Energji**" **shpk** ne shume 160 000euro sipas kotave qe ka sel ortak bazuar ne kontraten e shitblerjes dhe QKB.





Kushti i kontrates ka qene se Kalimi i pronesia nga shitesi tek bleresi do behet ne momenti e likujdimt te shumes prej 160 000euro.

Me qenese kjo shume nuk eshte likujduar pale me marrveshje kane rene dakorte qe kjo shume te likujdohet sipas parashkimeve te meposhtme:

Shuma prej 100 000Euro do te likujdohet brenda dates 18.01.2019 ne llogarin bankare te noteri Fran Gjoni shume e cila do te kaloje ne llogarin bankare te Petrit Preçi.

Diferenca prej 60 000 euro do te likujdohet brenda dates 18.07.2019.

Me likujdimin e shume prej 160 000euro pale do te paraqite prane nje zyre noteriale per te neshkruar deklarate noterial te plotesimit te kushti e cila do te nenshkruset nga Petrit Preçi dhe Besnik Leka.

**Me likujdimin e shumes prej 100 000euro e pasqyruar me mandat banakre dhe kushtin se do te likujdoje shume prej 60 000euro brenda dates 18.07.2019 shoqerise " NEW TECHNOLOGY HYDROPOWER " Shpk i lind e drejta beje kalimin e 100% te kuotave te Malido shpk ne QKB ne favorin e saje,me kushte keto kuota nuk do te tjetersohen deri ne likujdimin e shumes prej 60 000euro**

Nese shoqeria " **NEW TECHNOLOGY HYDROPOWER** " Shpk nuk kryen likujdimin e shumes prej 60 000Euro brenda dates 18.07.2019 pales shitese i lind e drejta qe te njoftoje palen bleses nepermje nje kujtese noterial dhe tia dergoje nepermjet postes shqiptare, me lajmrin marrje me shenimin "**Paraqituni per te likujdimin e shume prej 60 000euro**" dhe kjo kerkese do ti drejtohet tre here brenda 60 dite nga date 18.07.2019.

**Nese pas njoftim prej tre heresh pala blesese nuk pergjigjet,shuma prej 100 000euro e likujduar nga bleses humbet si kapare ne favor te shitesave.**

Pala shites i lind e drejta ti drejtohet gjykates se rrethit gjyqesore Lezhe per prishjen e kontrates per mos permbushje detyrimesh,kthim ne gjendjen e meparshme duke marre 100% kuotat ne vlere te plote pa shperblim.

Kjo kontrate shitje u perpilua ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil dhe te ligjit "Per noterine" si edhe te ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Kjo kontrate shitje pasi iu lexua paleve nga une Noteri, te cilet pasi e kuptuan dhe e gjeten sipas vullnetit te tyre te lire e te plote e nenshkruan rregullisht ne prani te Noterit.

**PALA SHITESE**

**SHOQERIA MALIDO SHPK**

*Reuben Dede H  
Anghelina Tashaj H  
Petrit Preçi*

**PALA BLERESE**

**SHOQERISE " NEW TECHNOLOGY HYDROPOWER**

*Besnik Leka*

**NOTERI**

**FRAN GJ.GJONI**

*18.07.2019*  
*[Signature]*